

# BULETINI INFORMATIV

**NDIHMJA JURIDIKE PËR PERSONAT NË RREZIK TË PASHTETËSISË/PASHTETËSI**

**JANAR - QERSHOR 2021**



*Senada dhe gjashtë fëmijët e saj - Foto nga CRP/K*

Një lajm i mirë për Senadën! Ajo më në fund mori dokumentet e gjendjes civile të Kosovës së bashku me gjashtë fëmijët e saj. Për gati dy vjet, stafi ligjor i CRP/K ishte angazhuar vazhdimisht në përfaqësimin dhe avokimin e të drejtave të tyre në organet administrative në nivel lokal dhe qendror. Rasti i Senadës është proceduar me sukses nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile. Së bashku me fëmijët e saj ajo tani mund të ketë qasje në shërbime dhe të gëzojë plotësisht të drejtat e saj.

#### SHKURTIMISHT:

- Përpos Senadës, 90 individë të pa dokumentuar, përfitues të ndihmës juridike falas janë pajisur me dokumente të gjendjes civile të cilat do të ju sigurojnë mundësinë për të shfrytëzuar të drejtat të tjera si kujdesi mjekësor, edukim, punësim, asistencë sociale si dhe shumë të drejta dhe shërbime të tjera themelore.
- Nga janari, 69 individë të pa dokumentuar kryesisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë identifikuar në nevojë për ndihmë juridike.
- Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka pajisur me letërnjoftim pa shtetësi 4 persona.



Me qëllim të përmirësimit të situatës së pjesëtarëve të pa dokumentuar të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, Koordinator i projektit të CRP/K-ës u takua me z. Habit Hajredini - Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Në takim, u diskutuan aktivitetet e të dyve dhe sinergjitë e mundshme në lidhje me ofrimin e mbështetjes për integrimin e tyre në shoqëri.

Për më tepër, po ashtu u përmend zbatimimi i aktiviteteve nga Deklarata e Poznanit me theks të veçantë në regjistrim, së bashku me bashkëpunimin e ardhshëm në këtë kontekst.

Mbështetje e vazhdueshme i është ofruar të gjithë aktorëve relevant për të parandaluar, identifikuar dhe zvogëluar numrin e personave në rrezik të pashtetësisë brenda popullatës së përegjistruar.

Në takim me z. Bekim Hoxha - Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, - Ministria e Punëve të Brendshme, janë prekur disa çështje të ndërlydhura me identifikimin e personave të përegjistruar, zhvillimin e një mekanizmi për zvogëlimin e lindjeve të përegjistruara, si dhe ndryshimet e nevojshme në kuadrin legjislativ përkatës i cili do të kontribuojë në promovimin e mëtejshëm të përpjekjeve në kuadër të fushatës globale të UNHCR "IBELONG".

Rëndësia e të pasurit një identitet ligjor, u theksua në vitin 2020 nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës përmes publikimit të Opinioneve Ligjore në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae), si dhe Raportit me rekomandime në lidhje me identitetin juridik të personave të përegjistruar.

Së bashku me UNHCR-ën, CRP/K po avokon vazhdimisht me Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës për zbatimin e këtyre rekomandimeve, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me përshejtimin e procesimit të rasteve të inicuar në procedurë gjyqësore nga stafi ligjor i CRP/K-ës, si dhe ndërmarrjen e masave brenda kompetencave dhe përgjegjësiave ligjore të institucioneve shtetërore në lidhje me identitetin juridik të personave të përegjistruar.

## NDIDHMA JURIDIKE E DHËNË PËR PERSONAT PASHTETËSI

E drejta për identitet ligjor, si dhe të qeniurit anëtarë efektivë të një shoqërie me të drejta dhe detyrime të barabarta është e drejtë e çdo individi.

Personat pa shtetësi janë veçanërisht të prekshëm në çështjet që ndërlidhen me shërbimet e ofruara nga institucionet shtetërore, veçanërisht në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor, edukim, punësimin dhe asistencë sociale.

CRP/K vazhdon të promovojë zgjidhje ligjore për të gjithë personat pashtetësi të cilët nuk mund të marrin shtetësinë në përputhje me kornizën ligjore të përcaktuar në Kosovë.

Përveç disa individëve të identifikuar që plotësojnë përkufizimin e personit pa shtetësi, përmes mbështetjes së ofruar nga personeli ligjor i CRP/K-ës në përfaqësimin dhe avokimin e të drejtave të tyre në organet administrative, është bërë i mundur aplikimi për letërnjoftim për personat pa shtetësi për 4 individë, duke u siguruar atyre identitet ligjor si dhe qasje në të drejta dhe shërbime të tjera. Pajisja e prindërve me letërnjoftim, i ka mundësuar CRP/K -ës të vazhdojë tutje me regjistrimin e lindjes së tre fëmijëve të tyre.



Lumturija është pajisur me letërnjoftim pashtetësi, duke i mundësuar asaj të aplikoj për regjistrimin e fëmijëve të saj - Foto nga CRP/K



Bashkëpunimi i ngushtë me Zyrtar Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) është më se i rëndësishëm për adresimin e duhur të kërkesave të individëve të pargjistruar.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i CRP/K-ës me ZKGJC-ët ka përmirësuar procesin e regjistrimit të gjendjes civile të individëve të pargjistruar si dhe ka lehtësuar zbatimin e kuarit ligjor në fuqi.

Takimet e mbajtura me ZKGJC shërbyen si një mjet avokimi për adresimin e duhur të 20 rasteve komplekse.

Gjatë takimeve, CRP/K shpërndau raportin "Një Rrugë Drejt Identitetit - Tregime Suksesi", publikimi i të cilit u financua nga UNHCR - Zyra e Shefit të Misionit në Kosovë, si dhe maska mbrojtëse në kuadër të fushatës së UNHCR-ës #BELONG.

Në takim me zyrtarë nga Zyra Rajonale për Ndhmë Juridike Falas në Prishtinë, diskutimet përfshinin çështje të ndryshme në lidhje me situatën aktuale me Covid-19, sfidat në ofrimin e ndihmës juridike dhe vështirësitë me të cilat përballen anëtarët e komunitetit në lidhje me regjistrimin e gjendjes civile si dhe qasjen në shërbime të ndryshme.

Bashkëpunimi ekzistues midis CRP/K-ës dhe Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas, u vlerësua si shumë i rëndësishëm në harmonizimin e një qasjeje strategjike dhe të përbashkët ndaj shqetësimeve dhe çështjeve të ndryshme me të cilat ballafaqohen anëtarët e këtyre komuniteteve.

Mjetet alternative të komunikimit të krijuara tashmë me personat në nevojë i kanë mundësuar stafit ligjor dhe avokuesit të komunitetit të vazhdojnë komunikimin me individë të pargjistruar si dhe të identifikojnë nevojat për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Petriti, avokues i komunitetit i CRP/K-ës i cili mbulon rajonin e Gjakovës, është gjithmonë pranë personave të pargjistruar në identifikimin e nevojave të tyre për regjistrim dhe pajisje me dokumentacion të gjendjes civile.



ÇDO JETË KA RËNDËSI.VAKSINOHUNI!



PËR MË SHUMË INFORMACION:

+383 (0) 38 243-610 | RR. LORENC ANTONI, NR.15, 10000 - PRISHTINË